



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Parashtrime mbi Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara
dhe/ose Dorëzim të Versioneve të Redaktuara Publike të Parashtrimeve të
Protokolluara**

T'u njoftohet:

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses), lëshon këtë urdhër për parashtrime mbi riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara dhe/ose dorëzim të versioneve të redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 prill 2024, në fund të seancës së deklaratave përmbyllëse Kryegjykatësja e deklaroi çështjen të mbyllur.¹

2. Më 9 korrik 2024, Trupi Gjykses caktoi mbajtjen e seancës së shqiptimit të Aktgjykimit për të martën, 16 korrik 2024, në orën 14:00.²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 21(2), 23(1), 40(2) dhe (4) dhe 43(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80(1), 82(3), 84(1) dhe 159 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. ANALIZË

4. Duke pasur parasysh caktimin e datës për shqiptimin e Aktgjykimit, Trupi Gjykses do të ushtrojë detyrën e tij sipas rregullës 84(1) të Rregullores për rishikimin e klasifikimit të disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, përfshirë edhe vendimet e tij, në mënyrë që të respektohet parimi i procesit publik, siç përcaktohet në nenet e 21(2) dhe 40(4) të Ligjit, i cili zbatohet

¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 17 prill 2024, publik, f. 4374, rreshtat 8-10.

² KSC-BC-2020-04, F00843, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit*, 9 korrik 2024, publik.

jo vetëm për seancat gjyqësore, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe dokumente të tjera në dosjen e çështjes.³

5. Në lëshimin e këtij vendimi, Trupi Gjykses mban parasysh, nga njëra anë, parimin e procesit publik dhe, nga ana tjetër, detyrën e tij për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, si edhe të informacionit konfidencial, në përputhje me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të rregullores.

6. Për të ndihmuar Trupin Gjykses në kryerjen e detyrës së tij sipas rregullës 84(1) të rregullores, urdhërohet Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) të bëjë të ditur nëse këto parashtrime të protokolluara, përfshirë edhe shtojcat, mund të riklasifikohen si publike, sipas renditjes së mëposhtme:

- F00286, konfidencial;
- F00297, konfidencial;
- F00310, konfidencial;
- F00329, konfidencial;
- F00331, konfidencial;
- F00337, konfidencial;
- F00343, konfidencial;
- F00356, konfidencial;
- F00436, konfidencial;
- F00473, konfidencial;
- F00624, konfidencial;

³ KSC-BC-2020-05, F00492, Trupi Gjykses, *Urdhër për Parashtrime mbi Riklasifikimin e Parashtrimeve dhe/ose Dorëzim të Versioneve të Redaktuara Publike dhe/ose Konfidenciale të Parashtrimeve*, 15 dhjetor 2022, publik, para. 5.

- F00818, F00818/A01, dhe F00818/A03, konfidenciale.

7. Urdhërohet Mbrojtja për Pjetër Shalën (Mbrojtja) të bëjë të ditur nëse mund të riklasifikohen si publike këto parashtrime të protokolluara, duke përfshirë edhe shtojcat, sipas renditjes së mëposhtme:

- F00296, tani konfidencial;
- F00317, tani konfidencial;
- F00348, konfidencial;
- F00352 dhe F00352/A01, konfidenciale;
- F00370, konfidencial;
- F00382, konfidencial;
- F00392, konfidencial;
- F00416, konfidencial;
- F00446, konfidencial;
- F00467, konfidencial;
- F00664, konfidencial;
- F00689, konfidencial;
- F00819, konfidencial;
- F00821, konfidencial.

8. Urdhërohet Mbrojtja e Viktimave të bëjë të ditur nëse mund të riklasifikohen si publike parashtrimet e mëposhtme të protokolluara:

- F00417, konfidencial;
- F00804, konfidencial;
- F00815, konfidencial.

9. Nëse ZPS-ja, Mbrojtja ose Mbrojtja e Viktimave dëshirojnë të ruajnë klasifikimin e tanishëm të ndonjë prej parashtrimeve të protokolluara të përmendur më lart, ata duhet: (i) të japin arsyet konkrete për ruajtjen e klasifikimit të tanishëm në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores dhe të bëjnë të ditur nëse dhe kur mund të ndryshohet klasifikimi; ose (ii) të dorëzojnë versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse.

10. Gjithashtu, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të urdhërojë Administratoren të riklasifikojë si publik parashtrimin e mëposhtëm të protokolluar:

- F00673, konfidencial.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **URDHËRON** ZPS-në të bëjë të ditur deri **të premten, 26 korrik 2024**, nëse parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafin 6 më lart (me përjashtim të F00818-ës, F00818/A01-shit dhe F00818/A03-shit) mund të riklasifikohen si publike ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten, 26 korrik 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse;
- b) **URDHËRON** ZPS-në të bëjë të ditur deri **të premten, 23 gusht 2024**, nëse mund të riklasifikohen si publike parashtrimet e protokolluara F00818, F00818/A01 dhe F00818/A03 ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten, 23 gusht 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse;
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen të bëjë të ditur, deri **të premten, 26 korrik 2024**, nëse parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafin 7

më lart (me përjashtim të F00819-ës dhe F00821-shit) mund të riklasifikohen si publike ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten, 26 korrik 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse;

- d) **URDHËRON** Mbrojtjen të bëjë të ditur, deri **të premten, 23 gusht 2024**, nëse parashtrimet e protokolluara F00819 dhe F00821 mund të riklasifikohen si publike ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten, 23 gusht 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse;
- e) **URDHËRON** Mbrojtjen e Viktimave të bëjë të ditur, deri **të premten, 26 korrik 2024**, nëse parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafin 8 (me përjashtim të F00804-ës dhe F00815-ës) mund të riklasifikohen si publike ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten 26 korrik 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse;
- f) **URDHËRON** Mbrojtjen e Viktimave të bëjë të ditur, deri **të premten, 23 gusht 2024**, nëse parashtrimet e protokolluara F00804 dhe F00815 mund të riklasifikohen si publike ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit të tyre, ose të dorëzojë deri **të premten 23 gusht 2024**, versionin/versionet e redaktuara publike përkatëse; dhe
- g) **URDHËRON** Administratoren që, deri **të premten 26 korrik 2024**, të riklasifikojë si publike parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafin 10 të këtij urdhri.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 11 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.